

WORKSHOP-PRISHTINA E VJETER, "DODONA"

DATA:02.06.2022

ORA16:00

VENDI: SHFMU "ELENA GJIKA"

PERMBAJTJA:

- 1.Regjistrimi i pjesëmarrësve
- 2.Qëllimi i takimit
- 3.Prezentimi i vizionit
- 4.Prezentimi i objektivave
- 6.Diskutim me qytetarët për Planin zhvillimor dhe Hartat zonale

PJESËMARRËS NË TAKIM

- 1.Perparim Rama - kryetar i Komunës
- 2.Alban Zogaj – nënkryetar i Komunës
- 3.Mimoza Sylejmani - drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik
4. Arbër Sadiki- drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit
5. Vllaznim Osmani - Kabineti i kryetarit
- 6.Donat Lushaku – drejtor i Drejtorisë së Kadastrit
- 7.Florian Dushi – drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit REGJISTRIMI

I PJESËMARRËSVE

(të bashkëlidhura i gjeni listat e nënshkrimeve)

## EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

### Të dëgjimit publik të qytetarëve të Prishtinës së Vjetër - lagjes “Dodona” në Prishtinë

**Mimoza Sylejmani** u prezentua para të pranishmëve dhe ju shprehu mirëseardhje të gjithë pjesëmarrësve. Ajo tha se me mua sot është edhe Alban Zogaj, nënkryetari i Komunës, Arbër Sadiki, drejtori i Urbanizmit, Vllaznim Osmani, shefi i Kabinetit, Donat Lushaku, drejtori i Kadastrit dhe Florian Dushi, drejtor i Inspeksionit. Kemi ardhur sot më shumë të bëjmë një bashkëbisedim sesa të ju prezentojmë ndonjë plan që e kemi bërë për lagjen e juaj. Unë bashkë me kryetarin dhe pjesën tjetër të ekipit do të përgjigjemi në të gjitha pyetjet që ju keni për ne. Tash për tash jemi në fazën që jemi, duke e bërë Planin zhvillimor komunal dhe Hartën zonale. Plani zhvillimor komunal, për ata që nuk e dinë, i

përcakton kufijtë e Prishtinës bashkë me fshatra, dhe Harta zonale është hartë rregulluese, ashtu si ka qenë më parë Plani rregullues, mirëpo tani nuk kemi plan rregullues por e kemi një hartë që e përfshinë

gjithë territorin e Prishtinës, ku do të kemi edhe ndërlidhjen mes zonës urbane e rurale. Prishtina e Vjetër përbëhet prej 38 hektarëve, të cilat janë në zonë të mbrojtur sipas Ministrisë së Kulturës dhe Institutit për mbrojtjen e monumenteve. Një hartë që e kemi siguruar së fundmi, që është miratuar në vitin 2019, është një hartë kjo që po e shihni (shfaqet në projektor). Këtu me vija të kuqe të errët është zona që është e mbrojtur, dhe kjo me të kuqe më të zbehtë tregon zonën në mbrojtje të përkohshme. Në lagjen tuaj siç po e shihni, i kemi 4 objekte në mbrojtje dhe 34 objekte në mbrojtje të përkohshme. Sot i kemi thirrur në takim edhe lagjen “Dodona” pasi jeni në kufij. Lagja “Dodona” shtrihet në 19.4 hektarë, e cila ka plan zhvillimor urban të miratuar nga Kuvendi komunal i Prishtinës në vitin 2005. E kemi edhe Planin 2004-2020 ka skaduar, tani ne jemi në zhvillim të Planit të ri, që po shpresoj se deri në fund të vitit, siç ka thënë edhe Kryetari, do të kemi si dokument të gatshëm dhe do e propozojmë në Kuvend për miratim. E kemi grupin punues, që deri tani ka punuar në mënyrë të ndarë, Ministria e Planifikimit, Ministria e Kulturës dhe Komuna. Tani jemi duke tentuar që ta punojmë së bashku. E kemi edhe një grup punues, i përbërë nga të gjitha drejtoritë, ku do të trajtojmë komplet zonën e Prishtinës së Vjetër, jemi duke u përpjekur që mos të futet një zonë kaq e madhe në mbrojtje nëse nuk është e nevojshme. Një tjetër premtim i kryetarit, në të cilin edhe jemi duke punuar, është ndërlidhja e sheshit me zonën e vjetër të qytetit. Tani siç edhe e keni parë, është duke u restauruar xhamia. Jemi në diskutim me Bashkësinë Islame, me Muzeun e kryeqytetit dhe Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve, të që mos kemi mure mes vete, po të ndërlidhemi, që t’ia rrisim vlerën kësaj zone. Ju më së miri e dini që është lagja e parë e kryeqytetit dhe i kemi ndërtesat e para që janë ndërtuar, nëse nuk gabo, në vitin 1944, kështu që jemi duke tentuar me e mbrojtur trashëgiminë tonë. E keni pa që jemi duke restauruar edhe Sahatkullën, tani jemi në diskutim për ta restauruar edhe Hamamin, i cili ka mbetur në gjysmë. Ashtu siç e ka thënë kryetari, sa më shpejt që është e mundshme ta rregullojmë edhe Tregun e qytetit. Në këto ilustrimet që po shihen (shfaqet skica në projektor), këtu mund ta shihni si është i projektuar, se si do të duket tregu, është i mbuluar dhe me standarde evropiane, me qenë një treg siç i ka hije një kryeqyteti.

**Arber Sadiki** bëri një prezantim të tij para të pranishmëve.

Ai tha se do të përpiqem pak a shumë me ju shpjeguar se si funksionojmë ne. Atë që po mundohemi ta bëjmë në lagjen tuaj, edhe në takimet që i kishim në lagjet e tjera, është të ju prezantojmë vizionin që e prezantoi kryetari në fushatën zgjedhore, se si e sheh ai kryeqytetin, ndërsa Drejtoria e Planifikimit e harton këtë vizion, e ne si Urbanizëm e zbatojmë. Ne jemi duke punuar në këtë projekt, por para se të

vijmë me një Plan final, edhe në takimet e mëhershme që i kishim, edhe me ju sot këtu do të diskutojmë e bashkëbisedojmë për problematikat, shqetësimet e kërkesat e juaja si banorë të kësaj lagjeje, që së bashku të punojmë, që në fund të ketë Plan, ta realizojmë në mënyrën më të mirë e më të kënaqshme për ju së pari, dhe për kryeqytetin. Përafërsisht ne i dimë se me çka ballafaqohet secila lagje, por këto informata nuk janë të mjaftueshme për atë se çfarë ne po duam të bëjmë, e qëllimi ynë është që të takohemi me banorët e secilës lagje e ti diskutojmë problematikat me juve, sepse ju më së mire e dini se çka mungon e çka nevojitet për një jetës më të mirë në lagjen tuaj. Secila lagje i ka karakteristikat e veta, e në këtë rast, lagjja juaj i ka karakteristikat që lidhen me trashëgiminë kulturore, ku nuk duhet te shihen si peng, por si potencial për zhvillim. Sot nga ju presim që të marrim ato çka neve na duhen për këtë plan, dhe në të njëjtën kohë edhe ju të pyesni e kërkon çka juve ju shqetëson.

**Florian Dushi** falënderoi kryetarin për këtë bashkëbisedim, duke thënë se është hera e parë që kemi kësaj lloji bashkëbisedimi të këtij formati. Siç e kemi biseduar edhe dhjetëra herë për këtë pjesë të qytetit e cila praktikisht ka mbetur si zonë qorre në kuptimin e planifikimit dhe zhvillimit, e që është pjesa qendrore e qytetit të Prishtinës. E tha edhe Arbri, e ka thënë edhe kryetari gjatë takimeve e konsultave që i kemi pasur, që në këtë pjesën tonë, d.m.th. në monumentet historike dhe çdo gjë kulturore që ndodhet në këtë lagje, e konsiderojmë që është me vlerë të ruhet, por kërkesë jona është që ne mos të penalizohemi për këtë fakt. Të caktohen kufijtë e saktë të këtyre zonave, e në anën tjetër pjesa tjetër, normal që sipas karakteristikave dhe planeve të lejohet dhe të zhvillohet si lagjet tjera të qytetit. Kryetari gjithmonë ka pasur mirëkuptim për një gjë të tillë, e unë sot duke qene në rol të dyfishtë, edhe si pjesë e ekipit të kryetarit, edhe si pjesë e juaja që jemi me gjenerata pjesë e kësaj lagjeje, jemi jashtëzakonisht të kënaqur për qasjen dhe trajtimin në përgjithësi që ka kryetari ndaj kësaj zone të qytetit.

**Kryetari** i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje, duke thënë se ndjej kënaqësi që sot jemi bashkë për t'i trajtuar hallet dhe kërkesat tuaja, për të diskutuar rreth zhvillimit, rigjenerimit të lagjes. Vizionin e transformimit të qytetit e kemi prezentuar në pika ndoshta të shkurtra më herët, mirëpo tani jemi në proces të planifikimit zhvillimor komunal dhe hartave zonale dhe detalizimit të të gjitha zonave.

Prishtina si kryeqytet ka një mundësi të hatashme për zhvillim, sot kemi mangësi të shumta në kryeqytet, kemi një potencial i cili është i fshehur, potencial i trashëgimisë kulturore, arkitektonike, i cili është pikërisht në këtë zonë, dhe ne duhet me i qitur në pah, për të mirën e komunitetit, për zhvillimin e bizneseve, për zhvillimin e mundësive për punësim, si hotele apo gastronomi. Në këtë proces të transformimit të Prishtinës duhet me e gjetur një balancë mes këtyre elementëve të ndryshëm. Parametri kryesor është mirëqenia juaj, krijimi i vlerave shoqërore. Ne nuk duhet të mendojmë vetëm për metra katrorë, por për vlerat shoqërore që janë, shkollat, çerdhet, vende rekreative, vende të gjelbëruara, qendra të Mjekësisë Familjare, të mjaftueshme për densitetin që po e bëjmë. Po ashtu, potencialin e ri të zhvillimit të turizmit, të zonës së Tregut të gjelbër etj. E kemi procesin e lidhjes së sheshit me Prishtinën e Vjetër me nënkalim për këmbësorë, me parkingje nëntokësore, për me e liruar ose me e qitur në pah pjesën e trashëgimisë kulturore. E kemi shkollën “Elena Gjika”, që mundemi me krijuar hapësira të sigurta përreth. Veç e kemi filluar këtë proces. Shumë fëmijë e prindër të kësaj shkolle kanë qenë pjesë e këtij procesi dhe e kanë parë që me një intervenim të thjeshtë dhe të vogël mundet me u krijuar një siguri shumë më e madhe për ta. Mandej e kemi pjesën e trashëgimisë kulturore, monumenteve të mbrojtura që ndodhen brenda në këtë zonë. Kjo nuk do të thotë që ne nuk mund të zhvillohemi në këtë zonë, por duhet të punojmë me një seriozitet të shtuar se si ta trajtojmë këtë zonë. Duke pas parasysh gjendjen ekzistuese të kësaj zone, ku kemi një numër të madh të ndërtimeve, kemi

problem me trotuare, me hapësirat e gjelbra, me kanalizimet, me vende rekreative e shume elemente të tjera. Duke i marrë parasysh krejt këto, jemi në proces për të krijuar një projektpropozim, një zhvillim të mirëfilltë, ku secili prej nesh, e gjithë lagjja përfitojnë si rezultat i zhvillimit. Sot kam dëshirë me ju dëgjuar, me bashkëbiseduar me juve, që me i qitur në pah elementet që ju mungojnë, ose mendoni që duhet me i pasur në përditshmërinë tuaj. Ne nuk jemi këtu për me e dëmtuar askënd, ato zona që vendosim, p.sh. për me i hapur, për me i bërë hapësira publike, kompensimi kalon në ndërtim në zonat ku ndërtohet me të njëjtin koeficient. Kjo është ideja që mos me e pësuar askush, por të gjithë të jemi të kënaqur në transformimin e kësaj zone historike, e kësaj zone të veçantë, që mos me e lënë siç tha Floriani, me herët zonë qorre, por me qenë zonë atraktive për ju, për turistë, edhe me u zgjidhur edhe problemet e tjera që ballafaqoheni ju në përditshmëri. Këto në pika të shkurtra janë të gjithë parametrat që ne ende jemi duke i shqyrtuar, por sot dëshiroj të bashkëbisedoj me ju, të ju dëgjoj juve çka keni për të thënë, por jo vetëm sot. Nga sot po fillojmë rrugëtimin tonë të përbashkët, marrim informata, i marrim parasysh të gjitha pikat që ju i keni cekur dhe herën tjetër kur të vijmë do të punojmë së bashku në projekt, në vizatime. Me rëndësi është që ju ta ndieni vetën të lirë me kërkesat, shqetësimet dhe prezentimet tuaja, ose ato mungesat që juve kishin me ju përmirësuar jetën e përditshme, kështu që së bashku me e ngritur vlerën e sigurisë, vetëbesimit e mirëqenies shoqërore.

**Shaip Fazliu**, banor i lagjes, pyeti se cilat rrugë janë të mbrojtura, ose cila pjese e lagjes është e mbrojtur, apo bëhet fjalë vetëm për monumente ku ato ndodhen.

**Arbër Sadiki** u përgjigj duke thënë se kufijtë e zonave të mbrojtura i cakton Ministria e Kulturës. Atë që ne po mundohemi ta bëjmë tash është që me u përfshirë edhe Komuna e Prishtinës në rishikim jo vetëm të kufijve, sepse kur bëhet një kufi nuk do të thotë që nuk mundet me u ndërtuar, por janë rregullat që parashihet se si do të zhvillohet ajo pjesë. Për atë ne jemi angazhuar disa herë me Ministrinë e Kulturës për t'i rishikuar edhe kufijtë edhe rregullat. Ju thash edhe më herët që secila pjesë e qytetit i ka karakteristikat e veta dhe ne nuk mund t'i neglizhojmë ato. Atë çka ne mund ta bëjmë, është të bëjmë më të mirën që secilës zonë me ia ruajtur elementet e karakteristikat e veta dhe të njëjtën kohë edhe me zhvilluar atë pjesë.

**Brahim Abazi** falënderoi kryetarin për këtë mundësi. Ai pyeti se me këta kufij ky plan a është afatshkurtër, afatmesëm apo afatgjatë.

**Lumnije Terdani**, banore në rr. "Edmond Hoxha", por tash e kanë ndërruar prapë emërtimin e rrugës, andaj nuk më duket i arsyeshëm ky ndërrim i emërtimit të rrugëve. Rruga jonë është në kufi me lagjen "Velanina", ne jemi me lagjen "Dodona", "Velania" po zhvillohet, "Dodona" ka ngecur. Uroj që ju të mbeteni në historinë e Prishtinës, duke iu kthyer Prishtinës së vjetër. Kjo zonë ka mbetur në gjendje shumë të keqe, rrugët e ngushta, parcelat janë të vogla ku investitori e ka problem. Kemi mbetur tepër keq, kanalizimi tmerr, ka shtëpi të uzurpuara, ka shtëpi të pa legalizuara, ka shtëpi që janë djegur gjatë luftës edhe e rrezikon jetën e qytetarit. Unë kam qenë në Inspektorat, jam ankuar gojarisht disa herë, por asgjë. Në zonën tonë bash kurrfarë investimi kisha pasur dëshirë me e ditur për rrugën tonë çfarë plani keni. Unë kisha propozuar që aty të ketë ndërtime kolektive e jo individuale.

**Memli Pajazitti**, jam pronar në këtë lagje dhe gjithashtu edhe ndërtues. Po flas për pronën time që ndodhet në këtë pjesën (tregon në skicë në projektor) që është në mes, e rrethohet nga Muzeu, Xhamia pak më lart, Gjykata, më poshtë është shtëpia e familjes Riza. Ne kemi marrë disa pëlqime për ndërtim

nga Ministria, pëlqimi i fundit është i vitit 2018. Nuk mendoj se paraqet ndonjë problem për monumentet e mbrojtura, do t'ju siguroj edhe dokumente nga Ministria e Kulturës.

**Donjeta Mejtani** tha se ne jemi një ndër familjet e shumta që janë dëmtuar në lagjen “Dodona”. Në vitin 2011 shtëpia jonë dhe shumë të tjera janë rrënuar, neve na është bërë padrejtësi, është ide e cila ka rrjedhur nga Komuna. Në atë kohë në qeverisje e ka qenë Isa Mustafa, i cili vetë i mbledh pronaret për këtë plan. Ka qenë e kontraktuar “Lesna Ndërtimi”, mirëpo lejen Komuna nuk e ka lëshuar, njëherë i kanë rrëzuar shpitë pa nxjerrë leje e mandej kanë dalë probleme me këto objektet që janë në mbrojtje kulturore, jo, nuk bën kinse me ndërtuar deri në 50 metra afërsi, e krejt këto Komuna ka pandehur se nuk i ka ditur. Si është e mundur që Komuna vetë mos me i ditur rregullat, të cilat rregulla ajo duhet t'u tregoj qytetarëve, e jo me ua rrezuar shtëpitë e tani jo janë rregullat! Kështu në zonën tonë nuk lejohet me u ndërtuar se është xhamia, dhe nuk bën të jetë ndërtimi më i lartë se kupola, kështu që parimisht koeficienti i cili ka qenë në 4.8 ka zbritur në 2.2. “Lesna Ndërtimi” është ndarë e pakënaqur me këtë gjë dhe i ndërprejnë të gjitha obligimet kontraktuale që i ka pasur me neve dhe pronarët e tjerët aty. Mandej vjen qeverisja 8-vjeçare e Shpend Ahmetit, i cili njëherë thotë që nuk mundeni me vazhduar pa plan të ri rregullues, mandej pa plan të ri zhvillimor, mandej pa Hartë zonale! Ne mandatin e tij të dytë Shpend Ahmeti, bashkë me Ministrinë e Planifikimit Hapësinor, e japin dritën e gjelbër që me vazhduar ndërtimet, por akoma nuk kanë filluar edhe nuk i kanë vazhduar ndonjëherë. E ne pronarët e shtëpive jo vetëm që kemi pasur dëme materiale, por këtu duhet me e pasur parasysh dëmin emocional, psikologjik që është shkaktuar.

**Mimoza Sylejmani** lidhur me diskutimin e parafolësës bëri një sqarim, duke thënë se nuk e ka dhënë Ministria dritën jeshile për të filluar me ndërtim, por është iniciuar në Kuvendin e Komunës për me filluar për Planin e hollësishëm të lagjes “Dodona”. Tani Ministria është duke i kthyer mbrapsht të gjitha dokumentet, se po thotë tash pasi po e hartoni Planin zhvillimor e Hartën zonale. Te gjitha këto probleme që ju i ceket tash, nuk kanë me u trajtuar me Hartë zonale.

**Donjeta Mejtani** pyeti se kur kryhen këto plane.

**Mimoza Sylejmani** u shpreh se nëse më keni dëgjuar më herët, e thash se brenda vitit duhet me e përfunduar Hartën zonale.

**Memli Pajazti** theksoi se në PZHU kanë qenë edhe pëlqimet e Ministrisë së Kulturës, ato ekzistojnë, a mundet Ministria çdo ditë me qitur pëlqime të reja për monumente të caktuara, se faktikisht tash e 20 vjet duke u punuar me ato pëlqime.

**Arber Sadiki**, Plani urbanistik, atë që e përmende PZHU-ja, është dokumenti bazë, në bazë të të cilit ne lëshojmë leje ndërtimore, por jo i vetmi. Në momentin kur ne e kemi në Planin zhvillimor urbanistik, një zonë që është zonë brenda kufijve të mbrojtur, ne jemi të obliguar në raste të tilla me ju referuar edhe dokumenteve tjera të cilat në këtë rast i harton Ministria e Kulturës, dhe ne nuk mund të bëjmë shkelje ligjore. Nëse një ndërtim brenda asaj zone procesohet vetëm me Planin zhvillimor urbanistik, por jemi të detyruar që me iu bindur edhe kriterëve që përcaktohen nga dokumente tjera. Kjo është ajo çka e thash më herët që jemi në koordinim me Ministrinë që këto mospërputhje, siç e thatë edhe ju më herët, që ka shtëpi që nuk ekzistojnë më, por janë në mbrojtje ose ka zona për disa lumenj p.sh. që janë në mbrojtje të cilët vetëm lumenj më nuk janë. Kemi edhe plot zona të tjera që është vështirë me i mbajtur peng, me i lënë pa zhvilluar, pa i hy diskutimit pak me thellë. Kjo është ajo çka ne po përpiqemi me e bërë me Hartat zonale, që të kemi një dokument, në të cilin do të jen të gjitha informacionet. Ne tash jemi në

proces të hartimit të GIZ-it, për ata që nuk e dinë, GIZ është një program i cili ta mundëson që me një data-bazë, me një klik me i pasur të gjitha hartat njëra mbi tjetrën, që t'i minimizojmë këto lloj problemesh që në të njëjtën zonë mund të ketë trajtime të ndryshme të zhvillimit të asaj zone. E ju që i keni këto probleme të kësaj natyre që i keni peng mes vite, e lëmë e takohemi një ditë edhe i diskutojmë të gjitha.

**Shkëlzen Gjevori** tregoi se është njëri nga tre përfaqësuesit e zonës, saktësisht rr. "Antigona Fazliu". Në rrugën tonë ka ndërtime 6+2, 7+2, ata kanë mundur me ndërtuar, kurse pjesa tjetër nuk është lejuar, dhe koeficienti që ka qenë i përcaktuar në zonën tonë është 1.2. Ne nuk jemi për me caktuar koeficient, atë e bëni ju, por kërkojmë që mos të jemi të diskriminuar, në planin e ri. Po shpresoj që të bëni një balancim në ndërtime në zonën tonë, edhe të merret në konsideratë vlera e tokës. Ne jemi për ndërtim, por asnjëherë për të bërë shëmtim të zonës, apo për t'ia ulur vlerën, siç ka ndodhur me objektet që veç janë ndërtuar.

**Arbër Sadiki** u shpreh se sikur edhe zonat tjera, edhe në këtë zonë ne do t'i marrim parasysh të gjitha, asnjë zone e qytetit nuk do të trajtohet pa e marr parasysh vlerën e tokës. Ne e kuptojnë që një pronar e ka vlerë atë se e ka fituar me mund. Në çfarëdo propozimi që do ta bëjmë ne do ta marrim për bazë, por duke e balancuar edhe me interesat publike, mundësitë reale, dhe kjo bëhet vetëm me rigjenerim komplet të asaj zone, si tërësi urbane. Duhet edhe ta kuptoni që arsyeja pse ekziston një komunë është që ta mbrojë interesin publik, dhe ne jemi këtu që ta balancojmë interesin publik me interesin privat pa e shkelur asnjëherë palë.

**Ekrem Ismaili**, banor i lagjes, tha se rruga rreth parkut ish-Adriatiku, jemi mbet në këtë pjesë të qytetit si në humnerë, problemet më të mëdha që 20 vjet pas lutës i ka pasur kjo pjesë, si për investime, kanalizim, ujësjellës, ndriçim, rrugë, trotuare. Me dalë me kaluar në mbrëmje, p.sh. pas orës 18 këtu e ke errësirë komplet. Pastaj ku është siguria e fëmijëve që shkojnë në shkollë?! Hartat zonale është problemi i fundit. Parësore duhet të jetë mirëqenia e banorëve. E kisha lutur kryetarin e drejtorin e Urbanizmit që të bëjnë zgjidhje së paku për fëmijët tanë.

**Kryetari** theksoi se e përmenda edhe me herët që rritja e sigurisë, mirëqenia për ne është elementi kyç. Plan i zhvillimor urbanistik merr kohë, por ne në ndërkohë duhet sanuar problemet e përditshme që e vështirësojnë jetën e qytetarëve. Për atë edhe jemi këtu, që t'i dëgjojmë. Edhe më herët u tha që me vite ballafaqoheni me problemet e njëjta, këto janë parësore, sidomos siguria e fëmijëve, jemi në proces duke i testuar, analizuar shumë rrugë, sidomos ato afër shkollave, me mundësi të bëhen njëkahore, të kemi trotuare të lira për këmbësorët, të intervenohet në ndriçim e në shumë mangësi të tjera. Ju kisha lutur që më herët që u tha për problemet me pronat që i keni me vite, ne e caktojmë një takim edhe i diskutojmë së bashku.

**Gani Lluga**, sociolog, banor i lagjes, rr. "Demir Viti", theksoi se po bëhet ndërrimi i emrave të rrugëve pa nevojë. Ne e kemi propozuar që rruga jonë të quhet "Jusuf Gërvalla". Ai parashtoi disa kërkesa: 1) Në planet tuaja që janë në proces, të jenë qytetarët pjesëmarrës në vendimmarrje qytetare, 2) Kabllot e rrymës nuk e di a jeni përgjegjës i juaja apo e KEDS-it, e kanë lënë në gjysmë punën, 3) Gjatë procesit të Planit ju kisha lutur që të gjitha informacionet t'i hidhni në ueb-faqe, që me pasur qasje edhe ne qytetarë.

**Fehmi Veseli**, ekonomist, banor i lagjes ish-Adriatiku, tha se KEDS-i, ka punuar me rrymën dhe rrugën e kane bërë tmerr, andaj të ndreqen kubzet e rrugës, emrat e rrugëve ndërrohen tërë kohën edhe

ndriçimi në këtë rrugë urgjent duhet të ndreqet. Po me intereson çka do të bëhet me rrugën ish-“Morava”, aty shtëpitë janë të vjetra, gati ne shembje, e fëmijët andej kalojnë dhe nuk ka siguri për ta.

**Perihan Uka** tha se kabllot e rrymës janë kapur në ballkonit tim, ato janë krejt të hapura, mandej paraqesin rrezik gjatë dimrit, a keni ndërmend me i ndrequr. Qarkullimi i veturave paraqesin një kaos të vërtetë.

**Arbër Sadiki**, bëri të ditur se përgjegjës për punimet me rrjetin elektrik është KEDS-i . Me sa e di, projekti parasheh që deri në vitin 2023-2024 asnjë kablo të mos mbetet në sipërfaqe por të futen nën tokë.

**Illir Morina**, banor i lagjes, rr. “Hamdi Morina”, u shpreh se rruga është njëkahore, por nuk ka shenjë, edhe mandej bllokohen kerret në rrugë. Edhe unë në pronën time nuk mund të ndërtoj, kjo nuk është në rregull. Ose le të më lejohet ndërtimi, ose më tregoni se çka keni në plan për rrugën tonë, mos na mbani peng.

**Kryetari** theksoi se drejtoresha e përmendi në fillim që këtë vit e përfundojmë Planin zhvillimor dhe Hartat zonale, po synojmë që deri në shtator, por do të kemi edhe diskutime shtesë e deri në fund të vitit ta finalizojmë. Vlefshmëria e këtij plani është 8 vjet e pas 8 viteve prapë duhet rishikuar e ridizajnuar.

**Kadri Zylfiu**, banor i lagjes, rr. “Antigona Fazliu”, tha se ne i kemi dërguar 99 nënshkrime të banorëve të rrugës sonë. Unë posedoj 1000 m katrorë, përballë meje është objekti 7 katësh pa asnjë hapësirë gjelbërimi, tjetri 6 kate, më poshtë është objekti 9 kate, ne po ndihemi të diskriminuar. Unë nuk kisha dashur me ndërtuar ashtu, por me gjelbërim, e jo me shëmtuar rrugën. Kërkesa që të na lejohet ndërtimi, e në rrugën tonë ka ndërtime edhe pa leje, ne po ndihemi të diskriminuar, sepse nuk po na lejohet ndërtimi.

**Kryetari** bëri të ditur se procesi i rigjenerimit i merr parasysh të gjitha këto pika, të gjitha këto probleme urbane për me i trajtuar qytetarët barabartë, bëhen analiza, dihet gjendja ekzistuese, cilat janë mangësitë edhe cilat janë mundësitë. Të gjitha tokat do të trajtohen njëjtë, nëse p.sh. në tokën tënde parashihet gjelbërim, koeficienti që është paraparë për ndërtim, e gëzoni të drejtën edhe ju në atë zonë. Askush nuk humb në këtë proces, do të krijojmë vlera dhe do të zgjidhim problemet që janë.

**Shaip .....** tha se para 10 vjetëve kemi bërë një petition për ndërtim të lartë me koeficient 4, a do të pranohet kërkesa. Në zonën tonë ka edhe ndërtime pa leje edhe kufij, qysh do të përcaktohen, a do të ndryshojnë.

**Kryetari** u shpreh se kufijtë që po shihen tani nuk i kemi vendosur ne, por janë të vendosura prej vitit 2019. E kemi formuar grupin punues, ne jemi në bashkëpunim me të gjithë me UN “Habitat”, edhe me Ministrinë e Kulturës, që me i rishikuar këta kufij, por siç e cekëm edhe më herët, kufijtë nuk do të thotë që ajo pjesë nuk mundet me u zhvilluar. Sa i përket pyetjes për ndërtimin e lartë, nëse duam të krijojmë hapësira të gjelbra, rekreative, me e zhvilluar atë pjesë ne duhet gjithsesi me e ngritur lartësinë, që me liru hapësirë, normal që balancohet në gjithë zonën, jemi në proces duke punuar.

**Edita Gashi**, banore e lagjes, blloku i parë, u shpreh se unë e kam dorëzuar edhe me e-mail kërkesën time, ka qenë për fasadën e blloqeve, ju falënderoj që më jeni përgjigjur. Siç e dini z. kryetar, blloqet janë ndërtesat e para të Prishtinës, janë në gjendje të mjerueshme, kush ka pasur mundësi i ka rregulluar, një pjesë nuk është, NPB-ja i ka rinovuar vetëm 2 hyrje, andaj ju kisha lutur që në Planin tuaj

rregullues t'i keni parasysh. Unë kam disa kërkesa: 1. Të rrënohet shtëpia e vjetër, sepse është rrezik për kalimtarët, një inspektor ka qenë e ka pa, e ku ka mbetur puna nuk e di, 2. Tjetri problem është që mundësisht rrugët të bëhen njëkahore, është me urgjencë, mandej problemi me bërlllokun, dhe për qentë endacakë, besoj që ato ju veç i dini.

**Vllaznim Osmani** ju propozoi të gjithë banorëve të blloqeve të bëjnë një kërkesë te NPB-ja për rinovimin e hyrjeve tjera. Mendoj që më mirë është ta bëni kërkesën së bashku se individualisht, se vërtet blloqet duken shumë keq.

**Florian Dushi** u shpreh se është rasti që kemi dalë me inspektuar menjëherë pas lajmërimit, inspektorët me siguri janë në përgatitje të procesit, behet fjale për një pronë të Komunës, që unë do të thosha që i plotëson të gjitha kushtet e rrezikshmërisë. Duhet me u rrënuar, besoj që shumë shpejt do të kryhet edhe kjo punë.

**Agim Raifi**, banor i lagjes, rr. "Bajram Kelmendi", tha se nuk ka shporta për mbeturina edhe në rrugën tonë ndodhen 4 supermarkete që furnizimet i kanë pa kurrfarë orari edhe e bllokojnë rrugën, plus veturat që parkohen vend e pavend.

**Mimoza Sylejmani** bëri të ditur se është duke u bërë rregullorja për furnizuesit, së shpejti do të aprovohet që furnizuesit të kenë kohën e caktuar për furnizim.

**Arben Bytyqi**, banor i lagjes, rr. "Zenel Salihu", shkaku i kushteve nuk më është lejuar ndërtimi. Unë e kam pronën, por nuk mundem me e shfrytëzuar, andaj a ka me pasur Plan zhvillimor edhe për zonën tonë.

**Ramiz Çoçaj**, tha se jetoj në rrugën që na ndan nga Parku i Qytetit, kemi mungesë të ndriçimit, i kanë prerë dritat. Ju e dini që në Park ka varreza të vjetra, ato janë hapur edhe shihen kafkat e njerëzve dhe eshtrat. Unë e kam lajmëruar rastin, ende asgjë, mandej kanalizimi në lagjen tonë është tmerr.

**Arbnor Ziberi**, banor i lagjes, rr. "Bajram Kelmendi", tha se në rrugën tone janë ende disa shtëpi me baltë, që janë në rrezik dhe gati për shembje. Zona jonë ka mbetur e diskriminuar, ka ndërtime që janë lejuar dhe janë ndërtim i lartë, ka ndërtime pa leje.

**Bujar Shefiki**, banor i lagjes, rruga te Xhamia e Çarshisë, pyeti se a do të kemi dalje ne si banorë te lagjes kur të bëhet nënkalimi.

**Rron Morina**, banor i lagjes, rr. "Hamdi Mramori", te 4 Llullat, pyeti se pse nuk po lejohet ndërtimi në rrugën tonë.

Në grupin punues vullnetarisht kanë shprehur dëshirën të jenë këta banorë:

Zineta Nikoceviq, e mail - [teniz26@gmail.com](mailto:teniz26@gmail.com)

Vjollca Pllana, email - [vsapuk@gmail.com](mailto:vsapuk@gmail.com)

Rron Morina, email- [ronmorina19@gmail.com](mailto:ronmorina19@gmail.com)

Prishtina e Vjetër, "Dodona" 2022.







Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes

**Datë:** 02/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri        | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|-----|-------------------------|------------------|------------|
| 1   | ZANA ALAJ               |                  |            |
| 2   | OSMAN VITIA             |                  |            |
| 3   | Shqip Fazliu            |                  |            |
| 4   | BUJAR SHAPIRI           |                  |            |
| 5   | XHEMARI GJELAVICA       |                  |            |
| 6   | DI DIBRA                |                  |            |
| 7   | DRITON KOMOKI           |                  |            |
| 8   | Donjeta Mejtani         |                  |            |
| 9   | Shegajdin Mejtani       |                  |            |
| 10  | Shpresa Mejtani-Qollqer |                  |            |
| 11  | Fatmir Osmani           |                  |            |
| 12  | Arbnor Ziberi           |                  |            |
| 13  | ILIRIJE AHMETI          |                  |            |
| 14  | SHKELZEN BERILA         |                  |            |
| 15  |                         |                  |            |
| 16  |                         |                  |            |
| 17  |                         |                  |            |
| 18  |                         |                  |            |
| 19  |                         |                  |            |
| 20  |                         |                  |            |
| 21  |                         |                  |            |
| 22  |                         |                  |            |
| 23  |                         |                  |            |
| 24  |                         |                  |            |
| 25  |                         |                  |            |
| 26  |                         |                  |            |
| 27  |                         |                  |            |
| 28  |                         |                  |            |
| 29  |                         |                  |            |
| 30  |                         |                  |            |
| 31  |                         |                  |            |
| 32  |                         |                  |            |
| 33  |                         |                  |            |
| 34  |                         |                  |            |
| 35  |                         |                  |            |



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Lista e pjesëmarrësve

Tema: Problematikat e lagjes

Datë: 02/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri  | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|-----|-------------------|------------------|------------|
| 1   | Muhammed Dami     |                  |            |
| 2   | PEIRIT MORINA     |                  |            |
| 3   | Lavdim Iylfin     |                  |            |
| 4   | Lumunji Fidan     |                  |            |
| 5   | Prashin Iludharli |                  |            |
| 6   | Andi Ismaili      |                  |            |
| 7   | Erkanto Haxho     |                  |            |
| 8   | Hariz Prekshiti   |                  |            |
| 9   | Betim Navakazi    |                  |            |
| 10  | KEMAL ADILI       |                  |            |
| 11  | QAZIM RASHITI     |                  |            |
| 12  | FEDZULLAH RASHITI |                  |            |
| 13  | ERIM DUSHI        |                  |            |
| 14  | Sajida Beseni     |                  |            |
| 15  | Almet Nuta        |                  |            |
| 16  | ROD SALLIU        |                  |            |
| 17  | FRIM POLLOSHKO    |                  |            |
| 18  | FEHMIL VESILI     |                  |            |
| 19  | FATOS FIOKRI      |                  |            |
| 20  |                   |                  |            |
| 21  | AFERDITA YMERI    |                  |            |
| 22  | LAJME GOGAJ       |                  |            |
| 23  |                   |                  |            |
| 24  |                   |                  |            |
| 25  |                   |                  |            |
| 26  |                   |                  |            |
| 27  |                   |                  |            |
| 28  |                   |                  |            |
| 29  |                   |                  |            |
| 30  |                   |                  |            |
| 31  |                   |                  |            |
| 32  |                   |                  |            |
| 33  |                   |                  |            |
| 34  |                   |                  |            |
| 35  |                   |                  |            |



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



## Lista e pjesëmarrësve

Tema: Problematikat e lagjes

Datë: 02/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri  | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|-----|-------------------|------------------|------------|
| 1   | ERBEN ISMAILI     |                  |            |
| 2   | Jasmet Jashari    |                  |            |
| 3   | NEHU PAJAZITI     |                  |            |
| 4   | Hasan Zekaj       |                  |            |
| 5   | Hasan Zekaj       |                  |            |
| 6   | RON MORINA        |                  |            |
| 7   | Jakup Bicaj       |                  |            |
| 8   | Hasan Zekaj       |                  |            |
| 9   | JETA RAFUNA       |                  |            |
| 10  | Gëzim Pula        |                  |            |
| 11  | Qendrim Sopi      |                  |            |
| 12  | IRIJ GJINJA       |                  |            |
| 13  | RASTO ISMAILI     |                  |            |
| 14  | ARDIAN KONISHEVLI |                  |            |
| 15  | Fadi Ismaili      |                  |            |
| 16  | BASEI BERTSHA     |                  |            |
| 17  |                   |                  |            |
| 18  |                   |                  |            |
| 19  |                   |                  |            |
| 20  |                   |                  |            |
| 21  |                   |                  |            |
| 22  |                   |                  |            |
| 23  |                   |                  |            |
| 24  |                   |                  |            |
| 25  |                   |                  |            |
| 26  |                   |                  |            |
| 27  |                   |                  |            |
| 28  |                   |                  |            |
| 29  |                   |                  |            |
| 30  |                   |                  |            |
| 31  |                   |                  |            |
| 32  |                   |                  |            |
| 33  |                   |                  |            |
| 34  |                   |                  |            |
| 35  |                   |                  |            |





Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Lista e pjesëmarrësve

Tema: Problematikat e lagjes

Datë: 02/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri     | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|-----|----------------------|------------------|------------|
| 1   | SHKELZEN GJEVORI     |                  |            |
| 2   | KADRI ZYLFI          |                  |            |
| 3   | AVDI KAKHIA RI       |                  |            |
| 4   | AFRIM - TAFRSHI      |                  |            |
| 5   | FATMIR QAZIMI        |                  |            |
| 6   | V. PUKA              |                  |            |
| 7   | NAZEN KHAMDAZI       |                  |            |
| 8   | Ibrahim Kolmogari    |                  |            |
| 9   | Othman Kologjari     |                  |            |
| 10  | Gjergj Pllana        |                  |            |
| 11  | BESIM NAKAVAZI       |                  |            |
| 12  | EDITA KUGNEXHA GASHI |                  |            |
| 13  | RAMIR SHALLA         |                  |            |
| 14  | ZIJETA NIKOGENI      |                  |            |
| 15  | Ljupita NURFI        |                  |            |
| 16  | DRITON NURFI         |                  |            |
| 17  | KIMETE FALU          |                  |            |
| 18  | Ajnesa R. Golebocka  |                  |            |
| 19  | Donkham Gromiqi      |                  |            |
| 20  | Arta Pllana          |                  |            |
| 21  | IFETA NIKOGENI       |                  |            |
| 22  |                      |                  |            |
| 23  |                      |                  |            |
| 24  |                      |                  |            |
| 25  |                      |                  |            |
| 26  |                      |                  |            |
| 27  |                      |                  |            |
| 28  |                      |                  |            |
| 29  |                      |                  |            |
| 30  |                      |                  |            |
| 31  |                      |                  |            |
| 32  |                      |                  |            |
| 33  |                      |                  |            |
| 34  |                      |                  |            |
| 35  |                      |                  |            |



# KOMUNA E PRISHTINËS E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

## DREJTORIA

| AGJENDA-WORKSHOP-PRISHTINA E VIETER-DODONA |                                       | Përgjegjësit                                                       |
|--------------------------------------------|---------------------------------------|--------------------------------------------------------------------|
| ORA                                        | 02.06.2022                            |                                                                    |
| 16:00-16:10                                | REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE           |                                                                    |
| 16:10-16:15                                | RREGULLAT E MBARVAJTJES               | Mimoza Sylejmani / Drejtore e Drejtorisë për Planifikim Strategjik |
| 16:15-16:20                                | MIRESEARDHJA / FJALA HYRËSE           | Përparim Rama / Kryetar                                            |
| 16:20-16:30                                | PREZENTIMI I VIZIONIT                 | Përparim Rama / Kryetar                                            |
| 16:30-16:40                                | PREZENTIMI I PROCESIT TË DERITANISHËM | Arbër Sadiki / Drejtor i Urbanizmit                                |
| 16:40-16:50                                | PREZENTIMI I OBJEKTIVAVE              |                                                                    |
|                                            | THEMELIMI I GRUPIT PUNUES             |                                                                    |
|                                            | PËRMBLEDHJE                           |                                                                    |